


# Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2021

**Tiranë, më 13 Dhjetor 2021:** Bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit (TIK) gjatë vitit 2021, nga grup-mosha 16 - 74 vjeç, e përdorin internetin 79,3 % e popullsisë, nga të cilët 91,7 % e përdorin çdo ditë.

98,7 % e individëve kanë përdorur aparat celularë / telefona inteligjent (smart) për të hyrë në internet. Ndërkohë 22,8 % e popullsisë e përdorin internetin nëpërmjet laptopit dhe 8,8 % nëpërmjet tabletit.

98,3 % kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) dhe ky tregues ka shënuar rritje prej 2,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020.

Fig.1 Pajisjet kryesore të përdorura për të hyrë në internet 2020 - 2021, në %



## Familjet me akses në internet

Përqindja e familjeve shqiptare që kanë akses në internet është 88,3 %, krahasuar me 83,3 % të një viti më parë. 78,3 % ose 530.755 familje kanë akses në internet me rrjet fikse broadband (rrjet optike ose kabllor, ADSL, etj.), tregues i cili ka shënuar rritje prej rreth 9,6 pikë përqindje. Përqindja e familjeve me akses në internet nëpërmjet lidhjes "mobile broadband" (3G/4G, tablet, etj.), është 99,1 %, krahasuar me 90,7 % në vitin 2020.

**Përdorimi i TIK nga individët e grup-moshës 16 - 74 vjeç**


Individët e moshës 16-74 vjeç që kanë përdorur internetin në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, përfaqësojnë 79,3 % të popullsisë në studim. Tregues i cili ka regjistruar një rritje rreth 7,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020. Ndër to, përdoruesit e shpeshtë të internetit përfaqësojnë, 91,7 % të individëve (që përdorin internet çdo ditë / pothuajse çdo ditë) dhe 7,7 % (të paktën një herë në javë), krahasuar me 88,2 % dhe 10,8 % për të njëjtat kategori në 2020.

Nga ana tjetër, aktivitetet që kryhen nëpërmjet internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës të cilat kanë regjistruar rritjet më të larta janë: kërkim i informacionit për të mira dhe shërbime (3,7 pikë përqindje), kërkim i informacionit lidhur me shëndetin (2,6 pikë përqindje) si dhe thirrjet nëpërmjet internetit / video thirrjet (2,1 pikë përqindje).

**Përdorimi i e-qeverisjes**

Në vitin 2021 të gjitha kategoritë për kontaktet elektronike nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe disa shërbime publike, si faqet e internetit në lidhje me detyrimet e qytetarëve (p.sh. deklaratën tatimore, njoftimin për zhvendosje), të drejtat (p.sh përfitimet sociale), dokumentet zyrtare (p.sh letërnjoftim, certifikatë të lindjes), shërbimet arsimore publike (p.sh biblioteka publike, informacion mbi regjistrimin në shkollë ose universitet, shërbimet e shëndetit publik) kanë shënuar rritje. Rritja më e lartë është shënuar për kategorinë “shkarkimi apo printimi e formularëve zyrtarë” me 4,7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020. 97,5 % e individëve që kanë ndërvepruar me autoritet publike nëpërmjet internetit kanë mbetur të kënaqur me shërbimet publike të ofruara.

**Fig.2 Përdorimi i e-qeverisjes 2020-2021, në %**




**Përdorimi i e-blerje (blerje online)**

Blerjet “online” i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, blerjen e tyre nëpërmjet internetit (e-blerje) për qëllime personale nëpërmjet çdo lloji pajisjeje (desktop, i lëvizshëm ose i dorës, përfshirë telefonin celular ose telefon smart). Blerjet “online” janë kryer nga 21,4 % e popullsisë së

grup-moshës 16 - 74 vjeç “në 12 muajt e fundit”, nga momenti i kryerjes së intervistës, tregues i cili ka shënuar një rritje prej 1,9 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020. Ndër blerjet “online”, produktet / shërbimet që zënë peshën më të madhe janë rroba / këpucë / aksesorë me 88,9 %, të cilat kanë treguar një rritje nga viti 2020 me 4,1 pikë përqindje.

Gjithashtu edhe në vitin 2021, rritjen më të lartë e kanë shënuar blerjet “online” për “ushqime / pije nga dyqanet apo ofruesit” me 4,7 pikë përqindje.


**Fig.3 Shpërndarja e individëve për blerjet online, 2020-2021, në %**



**Aftësitë teknologjike dhe kompjuterike**

Në vitin 2021 të gjitha aftësitë teknologjike apo kompjuterike kanë shënuar rritje, ku rritja më e lartë është shënuar për aftësitë lidhur me: “instalimi i softwareve / aplikacioneve” dhe “transferimin e materialeve” përkatësisht me 8,6 pikë përqindje dhe rreth 6 pikë përqindje.

Fig.4 Shpërndarja e individëve sipas aftësive të TIK, 2020-2021, në %



**Përdorimi i TIK sipas grup-moshës**

Përdorimi i internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës tek të rinjtë e moshës 16 - 24 vjeç është 96,7 %. Individët e grup-moshës 65 - 74 vjeç, të cilët kanë deklaruar që nuk e kanë përdorur asnjëherë internetin zënë 51,1 %, tregues i cili është zvogëluar, krahasuar me vitin 2020.

**Tab.1 Shpërndarja e përdorimit të TIK sipas grup-moshës, 2020-2021, në %**

Grup-mosha	Përdoruesit e TIK							
	2020				2021			
	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur
16-24	94,8	0,6	1,3	3,3	96,7	0,4	1,1	1,9
25-34	90,2	1,3	3,0	5,5	94,7	0,5	1,2	3,6
35-44	82,3	2,2	3,9	11,6	88,4	0,3	2,6	8,7
45-54	68,7	2,5	6,1	22,7	78,6	0,9	3,9	16,6
55-64	52,1	2,3	7,1	38,5	64,7	1,1	6,9	27,4
65-74	33,5	0,9	8,8	56,8	40,3	1,4	7,3	51,1
<b>Gjithsej</b>	<b>72,2</b>	<b>1,7</b>	<b>4,9</b>	<b>21,2</b>	<b>79,3</b>	<b>0,8</b>	<b>3,6</b>	<b>16,3</b>


Përdorimi i internetit në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës ka shënuar përqindjet më të larta në kategorinë “çdo ditë / pothuajse çdo ditë”, në të gjitha grup-moshat, ku 91,7 % e popullsisë 16-74 vjeç e përdorin atë në baza ditore.

**Tab.2 Shpërndarja e shpeshhtësisë së përdorimit të TIK sipas grup-moshave, 2020-2021, në %**

Grup-mosha	Frekuenca e përdorimit					
	2020			2021		
	Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë	Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë
16-24	95,9	3,8	0,3	97,2	2,5	0,3
25-34	96,0	3,3	0,7	97,4	2,4	0,2
35-44	90,8	8,2	1,0	94,1	5,3	0,5
45-54	81,7	17,3	1,0	88,2	11,1	0,7
55-64	75,1	23,5	1,5	83,9	14,9	1,2
65-74	64,0	30,7	5,4	71,5	26,5	2,0
<b>Gjithsej</b>	<b>88,2</b>	<b>10,8</b>	<b>1,1</b>	<b>91,7</b>	<b>7,7</b>	<b>0,6</b>

Përdorimi i internetit me baza ditore ka regjistruar përqindjet më të larta në grup-moshat 25-34 vjeç ndjekur nga 16-24 vjeç.


Fig.5 Shpërndarja e përdorimit të internetit “çdo ditë/pothuajse çdo ditë”, sipas grup-moshave 2021, në %



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp), “gjatë tre muajve të fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, vihet re se mbi 95 % e popullsisë 16-74 vjeç kryejnë thirrje / video thirrje.

Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) “gjatë tre muajve të fundit” sipas grup-moshave (Fig.6) tregon se grup-mosha 25-34 vjeç ka shënuar përqindjen më të lartë 24,7% ndjekur nga grup-mosha 16-24 vjeç 20,7%.

Fig.6 Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje/video thirrje, sipas grup-moshave, 2021, në %



### Përdorimi i TIK sipas gjinisë

Përdorimi i internetit në vitin 2021 si për burrat edhe për gratë shënon vlerat më të larta për kategorinë “gjatë 3 muajve të fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, duke shënuar rritje prej 7,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020. Gjatë vitit 2021, 80,3 % e burrave dhe 78,3 % e grave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit “gjatë 3 muajve të fundit”.

**Tab.3 Shpërndarja e përdorimit të TIK sipas gjinisë, 2020-2021, në %**

Gjinia	Përdoruesit e TIK							
	2020				2021			
	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur	Gjatë 3 muajve të fundit	Midis 3 muajve dhe një viti më parë	Më shumë se 1 vit më parë	Asnjëherë nuk e kam përdorur
Burra	73,2	1,7	5,2	19,8	80,3	0,8	3,7	15,2
Gra	71,2	1,7	4,5	22,6	78,3	0,7	3,5	17,4
<b>Gjithsej</b>	<b>72,2</b>	<b>1,7</b>	<b>4,9</b>	<b>21,2</b>	<b>79,3</b>	<b>0,8</b>	<b>3,6</b>	<b>16,3</b>


Shpeshësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se përdorimi i internetit “çdo ditë / pothuajse çdo ditë” dominohet nga burrat me 50,7 %, ndërsa përdorimi i tij “të paktën një herë në javë” dominohet nga gratë me 53,1 %.

**Tab.4 Shpërndarja e shpeshësisë së përdorimit të TIK sipas gjinisë, 2021, në %**

Gjinia	Frekuenca e përdorimit			Gjithsej	
	2021				
	Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	Të paktën një herë në javë	Më pak se një herë në javë		
Burra		50,7	46,9	36,5	50,3
Gra		49,3	53,1	63,5	49,7
<b>Gjithsej</b>		<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>

Sa i përket blerjeve nëpërmjet internetit, sipas gjinisë, gjatë vitit 2021 gratë kanë kryer më shumë blerje për: “produkte për kujdes personal (kozmetikë, etj)”, “produkte për fëmijë apo lodra për ta” si dhe “produkte shtëpiake”. Ndërkohë burrat kanë shfaqur preferenca më shumë në blerjet për: “të mira dhe mallra sportive”, “shërbimet e ushqimit nga restorante / fast-food apo shërbimet catering” si dhe “ushqime apo pije nga dyqanet/ofruesit e ushqimit”.

Fig.7 Blerjet online sipas gjinisë, 2021, në %





# Metodologjia

Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët të grup-moshës 16-74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.

Të dhënat e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët do të shërbejnë si një nga inputet për llogaritjen e përdorimit të treguesve mbi teknologjitë e përdorura për informacion dhe komunikim nga familjet dhe individët.

Anketa mbledh të dhëna mbi çështje në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në familje dhe nga individët mbi: pajisjet e familjes për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (telefon, pajisje kompjuterike, akses në Internet), përdorimin e internetit, e-blerjeve, e-qeverisjes, etj. Për të analizuar më shumë aspekte të përdorimit të teknologjive të reja të cilat janë gjithmonë në zhvillim pyetësi është dinamik, kështu që çdo vit shtohen module të reja pyetjesh me periudha të ndryshme reference kohore.

Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët u krye për herë të parë në vitin 2018 me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2021, Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët u krye me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të vrojtitit u intervistuan rreth 5.272 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 73,2 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 10 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.

## **Mbledhja e të dhënave:**

Kryhet një interviste direkte nga anketuesit me pyetësor letër ku përfshihen pyetje për familjen dhe të dhënat bazë në lidhje me të, si dhe realizohet intervistë individuale për çdo person prezent në NjEF i grup-moshës 16-74 vjeç.

## **Struktura e pyetësorit:**

- Informacion i përgjithshëm;
- Karakteristikat demografike të anëtarëve të NjEF-së;
- Pyetësi Individual (karakteristika socio-demografike, modulet mbi përdorimin e TIK prej tyre).

**Përkufizime:**

**Një njësi ekonomike familjare (NjEF)** i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

**Periudha e referencës/referuese** është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar. Në vitin 2020 anketa është kryer në periudhën Gusht – Tetor 2020.

**Interneti** është sistemi rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdorë Suitën e Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese, dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless, dhe teknologjitë e rrjeteve optike. Interneti mbart një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe shërbimeve, të tilla si dokumentet e ndërlidhura hypertext dhe aplikacionet e World Wide Web (www), posta elektronike, telefonia dhe rrjetet peer-to-peer për file sharing.

**Akses** i referohet qasjes në internet jo vetëm në shtëpi por a mund anëtarët e familjes t'a aksesojnë atë kur /ku të duan.

**Shërbimi me Internet Broadband** është forma më e përdorur e qasjes në internet për shkak të shpejtësisë së lartë; ajo ofrohet në disa forma të ndryshme, DSL, ADSL gjithashtu fibra optike, kabllor dhe satelit, rrjete WiFi publike, përmes antenës.